

Banka e Shqipërisë

# ANALIZË E ZHVILLIMEVE NË SEKTORIN E JASHTËM TË EKONOMISË T3 - 2018

*Enian Çela*

*Departamenti i Politikës Monetare, Banka e Shqipërisë*

JANAR 2019

*Pikëpamjet e shprehura në këtë material janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.*



# P E R M B A J T J A

<i>I. ZHVILLIMET KRYESORE NË BILANCIN E PAGESAVE</i>	<i>5</i>
<i>II. LLOGARIA KORRENTE</i>	<i>7</i>
<i>III. LLOGARIA KAPITALE</i>	<i>10</i>
<i>IV. LLOGARIA FINANCIARE</i>	<i>10</i>
<i>V. PROFILI I FINANCIMIT TË DEFICITIT KORRENT</i>	<i>13</i>



## I. ZHVILLIMET KRYESORE NË BILANCIN E PAGESAVE<sup>1</sup>

Pozicioni neto i llogarisë korrente regjistroi një deficit prej 146.4 milionë eurosh në tremujorin e tretë të vitit 2018, duke u zgjeruar me rreth 2.6% në terma vjetorë. Ndikimi kryesor në zgjerimin e deficitit korrent ka buruar nga nënlllogaria e të ardhurave parësore dhe më konkretisht nga rritja e të ardhurave dalëse të lidhura me investimet direkte. Nga ana tjetër, kontributet në drejtim të ngushtimit të deficitit korrent kanë buruar nga nënlllogaria e mallrave dhe të ardhurave dytësore. Deficiti korrent u vlerësua në nivelin 4.5% ndaj PBB-së nominale, ose 0.4 pikë përqindjeje më i ulët se i njëjti tremujor i një viti më parë. Vlerësohet që në këtë drejtim ka ndikuar zgjerimi i raportit të kursimeve kombëtare ndaj PBB-së (shih hapësirën informuese për “Zhvillimet në hendekun e kursimeve dhe investimeve”).

Eksportet e mallrave dhe të shërbimeve shënuan rritje prej rreth 11.6% në terma vjetorë, ndikuar në masë të madhe nga zgjerimi vjetor i eksportit të shërbimeve me 8.4%. Rritja e eksporteve të kësaj kategorie është përcaktuar në masë të gjerë nga zgjerimi i shërbimeve të udhëtimit me rreth 16.2%. Në të njëjtën kohë, një rritje e lartë është konstatuar edhe në rastin e të mallrave. Zgjerimi në terma vjetorë, shënoi 27.9%. Për sa i përket importeve, rritja e përgjithshme për mallra dhe shërbime shënoi 7.8%. Ndikimi kryesor buroi nga rritja e importit të shërbimeve me rreth 14.3%. Sikurse në rastin e eksportit, edhe në rastin e importit të shërbimeve, rritja është përcaktuar nga zgjerimi i shpejtë i shërbimeve dalëse të udhëtimit (rritja vjetore shënoi 19.4%). Për këtë arsye, edhe teprica pozitive e nënlllogarisë së shërbimeve është ngushtuar me rreth 0.1% në terma vjetorë. Paralelisht, rritja e importit të mallrave shënoi vlerën 4.0%. Kjo rritje rezultoi e pamjaftueshme për të kompensuar efektin zgjerues të eksportit të mallrave. Si rrjedhojë, deficiti i nënlllogarisë së mallrave u ngushtua me rreth 1.8% në terma vjetorë dhe deficiti i përgjithshëm tregtar në mallra dhe shërbime u ngushtua me rreth 3.5%.

Suficiti i llogarisë së të ardhurave dytësore u zgjerua me 9.8% në terma vjetorë. Rritja vjetore e remitançave neto shënoi 2.6%, por ndikimi kryesor në zgjerimin e tepricës së nënlllogarisë buroi nga të ardhurat e tjera personale. Në të njëjtën kohë, është vënë re një zgjerim i të ardhurave hyrëse të “qeverisë së përgjithshme”. Flukset hyrëse neto në llogarinë kapitale shënuan vlerën 22.9 milionë euro dhe rezultuan rreth 7.5 milionë euro më të ulëta, kundrejt të njëjtit tremujor të një viti më parë.

<sup>1</sup> Të dhënat më të fundit të bilancit të pagesave i përkasin tremujorit të tretë të vitit 2018. Duke filluar nga tremujori i parë i vitit 2008, Banka e Shqipërisë harton Statistikat e Bilancit të Pagesave, në përputhje me standardet ndërkombëtare të parashikuara në Manualin e 6-të të Bilancit të Pagesave, publikuar nga FMN-ja. Ndryshimet kryesore mes metodologjisë aktuale dhe të mëparshme sintetizohen në udhëzuesin e mëposhtëm:

[http://www.bankofalbania.org/web/pub/shpjegues\\_per\\_ndryshimet\\_ne\\_publicimin\\_e\\_statistikave\\_te\\_sektorit\\_te\\_jashtem\\_sipas\\_bpm6\\_qershor\\_2014\\_2\\_6688\\_1.pdf](http://www.bankofalbania.org/web/pub/shpjegues_per_ndryshimet_ne_publicimin_e_statistikave_te_sektorit_te_jashtem_sipas_bpm6_qershor_2014_2_6688_1.pdf)

Për efekt analizash, të dhënat e Bilancit të Pagesave, nga viti 2002 deri në vitin 2007, u riklasifikuan në përputhje me metodologjinë e re nga Departamenti i Politikës Monetare.

Në llogarinë financiare, janë regjistruar detyrime neto në vlerën 11.1 milionë euro. Ky nivel llogaritet të jetë pakësuar në terma vjetorë me rreth 211.2 milionë euro. Faktor kryesor përcaktues ka qenë pakësimi i detyrimeve neto në formën e Investimeve Direkte me rreth 21.1%, krahasuar me një vit më parë. Në të njëjtën kohë, faktor ka qenë edhe zgjerimi i konsiderueshëm i mjeteve të rezervës.

Flukset neto hyrëse në llogaritë kapitale e financiare arritën të mbulojnë vetëm 23.2% të deficitit të llogarisë korrente dhe pjesa tjetër u mbulua nga hyrjet e "gabimeve dhe harresave". Bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi me një shtim të mjeteve të rezervës me rreth 154.8 milionë euro. Stoku i rezervës valutore është në gjendje të mbulojë 6.5 muaj import mallrash dhe shërbimesh, ose 160% të borxhit të jashtëm afatshkurtër bruto, në fund të tremujorit të tretë të vitit 2018.

Tabelë 1. Tregues të bilancit të pagesave (të dhëna në milionë euro)

	T1'17	T2'17	T3'17	T4'17	T1'18	T2'18	T3'18
Llogaria Korrente (në mil euro)	-157.5	-255.8	-142.8	-309.9	-170.7	-176.3	-146.4
vmv (%)	-20.4	-11.1	-3.9	74.5	8.4	-31.1	2.6
/ PBB-së (%)	-6.1	-8.4	-4.9	-10.2	-6.1	-5.2	-4.5
Mallra dhe shërbime	-311.7	-486.7	-373.8	-570.2	-360.1	-428.9	-360.7
vmv (%)	-22.7	-12.3	-9.0	30.5	15.5	-11.9	-3.5
Eksporte, f.o.b.	773.4	894.2	1110.0	875.6	840.0	1022.1	1238.8
vmv (%)	27.1	24.7	19.8	2.2	8.6	14.3	11.6
Importe, f.o.b.	1085.1	1380.9	1483.8	1445.8	1200.1	1451.0	1599.6
vmv (%)	7.2	8.5	10.9	11.7	10.6	5.1	7.8
Udhëtime neto	75.6	80.1	180.9	109.6	77.6	83.5	197.1
Të ardhura parësore	-14.7	17.4	18.8	7.1	-13.4	13.7	-18.4
Kredi	79.6	122.9	106.6	98.4	73.5	125.4	96.1
Debi	94.3	105.5	87.8	91.2	86.8	111.7	114.6
Të ardhura neto nga Investimet Direkte	-62.2	-81.8	-50.6	-46.4	-61.7	-89.1	-87.0
Të ardhura dytësore	169.0	213.4	212.2	253.1	202.8	238.9	232.8
Kredi	198.3	242.2	236.7	284.7	224.4	260.5	253.9
Debi	29.3	28.7	24.5	31.6	21.6	21.6	21.2
Dërgesa nga emigrantët -neto	135.1	162.7	165.8	172.1	148.6	181.7	170.0
vmv (%)	-0.5	5.7	3.9	4.1	10.0	11.7	2.6
Llogaria Kapitale	23.8	25.3	30.4	42.9	18.3	21.2	22.9
Huamarrje neto/Huadhënie neto	-133.7	-230.6	-112.3	-267.1	-152.4	-155.1	-123.5
Llogaria financiare	-295.9	-206.4	-222.3	-205.4	-287.9	-200.0	-11.1
vmv (%)	112.7	-22.7	144.2	72.0	-2.7	-3.1	-95.0
/ PBB-së (%)	-11.4	-6.7	-7.7	-6.8	-10.2	-5.9	-0.3
Investime direkte	-206.4	-225.9	-340.2	-221.3	-291.0	-222.6	-268.5
vmv (%)	63.3	-10.0	12.5	-13.8	40.9	-1.5	-21.1
Investime portofoli	-137.5	-21.6	31.2	27.9	3.5	110.6	13.1
Derivativë financiarë	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Investime të tjera	39.4	117.3	49.1	-227.3	142.0	-173.2	89.5
Mjetet e rezervës	8.6	-76.2	37.6	215.4	-142.4	85.1	154.8
Gabime dhe harresa	-162.2	24.2	-110.0	61.7	-135.5	-45.0	112.4


Burimi: Banka e Shqipërisë, INSTAT dhe llogaritje të autorit.

## II. LLOGARIA KORRENTE

Pozicioni neto i llogarisë korrente regjistroi një deficit prej 146.4 milionë eurosh në tremujorin e tretë të vitit 2018, duke u zgjeruar me rreth 2.6% në terma vjetorë. Deficiti u vlerësua në nivelin 4.5% ndaj PBB-së nominale, ose rreth 0.4 pikë përqindje më i ulët se në të njëjtin tremujor të një viti më parë. Krahasuar me tremujorin e dytë të vitit, raporti është 0.7 pikë përqindje më i ulët.


Në terma kontributesh, zgjerimi në terma vjetorë është përcaktuar gjerësisht nga dinamika në nënlogarinë e të ardhurave parësore. Teprica përkatëse ka shënuar flukse neto dalëse në masën 18.4 milionë euro, ndërkohë që një vit më parë shënonte një tepricë neto hyrëse prej 18.8 milionë eurosh. Përcaktues në këtë drejtim ka qenë zgjerimi i të ardhurave dalëse nga investimet (kryesisht të lidhura me investimet direkte) me rreth 26.2 milionë euro në terma vjetorë.

Në rastin e shkëmbimeve tregtare është vënë re një ngushtim i deficitit të përgjithshëm me rreth 3.5% në terma vjetorë. Përcaktues në këtë drejtim ka qenë ngushtimi i deficitit tregtar në mallra me rreth 1.8%. Më konkretisht, raportohet një rritje e shpejtë e eksportit të mallrave me rreth 27.9% në terma vjetorë. Nga ana tjetër, rritja e importeve ka rezultuar mjaft e ngadaltë (vetëm 4.0% në terma vjetorë).



Nënlogaria e shërbimeve raporton për një ngushtim të tepricës pozitive me rreth 0.1 % në terma vjetorë. Nga njëra anë, rritja e eksporteve ka rezultuar mjaft e lartë (8.4%), përcaktuar nga zgjerimi i shpejtë i shërbimeve të udhëtimit (16.2% rritje vjetore). Nga ana tjetër, edhe rritja e importeve ka rezultuar mjaft e lartë (rreth 14.3% në terma vjetorë) dhe përcaktues në dinamikën e tepricës së llogarisë. Edhe në rastin e importeve, ndikimi kryesor lidhet me shërbimet e udhëtimit (ritje vjetore 19.4%).


Grafik 2. Zërat kryesorë në llogarinë e shërbimeve (flukse neto në milionë euro)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Bilanci neto i **llogarisë së të ardhurave parësore** rezultoi negativ, sikurse u përmend edhe më parë. Deficiti i regjistruar u vlerësua në rreth 0.6% ndaj PBB-së nominale, i përcaktuar kryesisht nga llogaria e të ardhurave nga investimet. Nga ana tjetër, ngushtimi i tepricës përkatëse të llogarisë në terma vjetorë është përcaktuar nga zgjerimi i të ardhurave dalëse të investimeve.

Grafik 3. Bilanci i të ardhurave parësore (flukse neto, në milionë euro, majtas) dhe të ardhurat nga investimet direkte (flukse neto, në milionë euro, djathtas)




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Suficiti i **llogarisë së të ardhurave dytësore** është zgjeruar me rreth 9.7%, krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë. Suficiti përkatës shënoi 232.8 milionë euro, ekuivalent me 7.2% të PBB-së nominale. Rritja e remitancave neto shënoi 2.6% në terma vjetorë, normë kjo më e ngadaltë, krahasuar me gjysmën e parë të vitit (rritja vjetore shënonte 10.9%). Ndikimet kryesore në zgjerimin e tepricës janë përcaktuar kryesisht nga të ardhurat e tjera personale me ndikimet edhe nga të ardhurat hyrëse të “qeverisë së përgjithshme”.



Grafik 4. Dërgesat e emigrantëve (flukse neto, në milionë euro, majtas) dhe financimi i deficitit tregtar nga të ardhurat neto parësore, dytësore dhe nga shërbimet (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Të ardhurat neto kumulative nga llogaria e shërbimeve, e të ardhurave parësore dhe atyre dytësore, financuan rreth 80.2% të deficitit tregtar të mallrave. Ky raport është ngushtuar me 0.8 pikë përqindje, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2017, por është zgjeruar me rreth dhe 6.0 pikë përqindje, krahasuar me tremujorin e mëparshëm.


#### HAPËSIRË INFORMUESE: ZHVILLIMET NË HENDEKUN E KURSIMEVE DHE INVESTIMEVE

Hendeku kursime-investime i sektorit privat u vlerësua në -4.9% të PBB-së nominale (vlera negative e hendekut nënkupton investime më të larta se kursimet). Ky raport është 1.3 pikë përqindje më i lartë, krahasuar me të njëjtin tremujor të një viti më parë. Raporti i investimeve private ndaj PBB-së nominale vlerësohet në nivelin 19.5%, ndërkohë që një vit më parë vlerësohej në 17.7%. Nga ana tjetër, kursimet private ndaj PBB-së nominale vlerësohen në nivelin 14.6%, rreth 0.5 pikë përqindje më të larta se një vit më parë. Në tërësi, rritja më e shpejtë e investimeve kundrejt kursimeve ka qenë faktori pas zgjerimit të hendekut në sektorin privat në terma vjetorë, gjatë tremujorit në analizë.

Në rastin e sektorit publik, është vënë re një hendek pozitiv (kursime më të larta se investimet) në nivelin 0.4% ndaj PBB-së nominale. Ndërkohë, një vit më parë, hendeku vlerësohej negativ në nivelin 1.4% ndaj PBB-së nominale. Ecuria është përcaktuar kryesisht nga zvogëlimi i raportit të investimeve publike ndaj PBB-së nominale me 1.8 pikë përqindje, krahasuar me një vit më parë. Nga ana tjetër, raporti i kursimeve publike ndaj PBB-së nominale është ngushtuar me rreth 0.1 pikë përqindje, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2017.

Në tërësi, raporti i investimeve kombëtare ndaj PBB-së ka mbetur pothuaj i pandryshuar në tremujorin e tretë të vitit 2018, krahasuar me një vit më parë (në nivelin 23.7%). Në të njëjtën kohë, raporti i kursimeve kombëtare ndaj PBB-së nominale është zgjeruar në 19.2%, nga 18.8% një vit parë. Rritja e kursimeve kombëtare ka qenë edhe përcaktuesi kryesor në ngushtimin e raportit të deficitit korrent ndaj PBB-së nominale në 4.5%, nga 4.9% në të njëjtin tremujor të vitit 2017.

Grafik 5. Kontributi i treguesve të investimeve dhe kursimeve në dinamikën e deficitit (majtas) dhe kontributi i tyre në ndryshimin vjetor të deficitit të llogarisë korrente (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave.

### III. LLOGARIA KAPITALE


Në tremujorin e tretë të vitit 2018, teprica pozitive e llogarisë kapitale ishte rreth 22.9 milionë euro, rreth 7.5 milionë euro më e ulët, krahasuar me një vit më parë. Flukset kapitale neto në këtë llogari vlerësohen në 0.7% ndaj PBB-së nominale. Transfertet kapitale neto për llogari të "qeverisë së përgjithshme" ishin me tepriçë pozitive prej 4.9 milionë eurosh, ndërsa ato të "korporatave financiare dhe jofinanciare, ekonomive shtëpiake dhe institucioneve jofitimprurëse në shërbim të ekonomive shtëpiake", ishin 18.0 milionë euro.

Kombinimi i transaksioneve neto të llogarisë korrente dhe asaj kapitale jep pozicionin neto të ekonomisë vendase si huadhënës neto (suficit) dhe huamarrës neto (deficit), kundrejt ekonomive jorezidente. Në terma sasiorë, për tremujorin e tretë të vitit 2018, ekonomia jonë paraqet një pozicion neto huamarrës prej 123.5 milionë eurosh, i cili financohet nga llogaria financiare dhe zëri "gabime dhe harresa". Ky nivel rezulton 10.0% më i lartë, krahasuar me një vit më parë, por 20.9% më i ulët, krahasuar me tremujorin e dytë të vitit.

### IV. LLOGARIA FINANCIARE

Llogaria financiare regjistron një fluks detyrimesh neto prej 11.1 milionë eurosh për tremujorin e tretë të vitit 2018, rreth 95.0% më i ulët, krahasuar me një vit më parë. Detyrimet neto të kësaj llogarie u vlerësuan në rreth 0.3% të PBB-së nominale dhe financuan vetëm 7.6% të deficitit korrent të regjistruar gjatë kësaj periudhe.


Grafik 6. Llogaria financiare dhe gabime e harresa (flukse neto, në milionë euro)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

**Fluset neto të Investimeve Direkte** janë pakësuar me rreth 21.1% në terma vjetorë. Ndikimi kryesor në këtë drejtim buron nga flukset e sektorit energjetik, ku mbizotërojnë projektet e mëdha. Këto projekte janë tashmë në fazat përfundimtare të ndërtimit dhe pakësimi i flukseve prej tyre është i pritshëm.


Grafik 7. Përbërësit e llogarisë financiare (flukse neto, në milionë euro)



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pakësimi i flukseve të Investimeve Direkte ka ndikuar edhe raportin e këtyre të fundit ndaj deficitit korrent. Për tremujorin në analizë, flukset neto të investimeve direkte financuan rreth 183.4% të deficitit të regjistruar korrent. Ky raport ishte 54.9 pikë përqindje më i ulët se në të njëjtin tremujor të një viti më parë.

Grafik 8. Përbërja e investimeve direkte (flukse, në milionë euro, majtas) dhe raporti i financimit të deficitit korrent prej investimeve direkte neto (djathtas)




**Investimet e portofolit neto** shënuan një tepricë neto të mjeteve prej 13.1 milionë eurosh, ndërkohë që një vit më parë teprica shënonte mjete neto prej 31.2 milionë eurosh. Fluksi dalës i mjeteve vendase u pakësua me rreth 29.5 milionë euro në terma vjetorë. Nga ana tjetër, fluksi i detyrimeve pasqyroi një vlerë negative prej 10.2 milionë eurosh, duke nënkuptuar një pakësim të stokut të detyrimeve ndaj jorezidentëve.

**Nënlllogaria e investimeve të tjera** raporton për një tepricë të fluksit të mjeteve me rreth 89.5 milionë euro. Në rastin e mjeteve, dinamika është përcaktuar nga lëvizjet e “korporatave depozitëmarrëse”. Kështu, ky sektor raporton për zgjerim të mjeteve në formën e “monedhave dhe depozitave” dhe pakësim në rastin e mjeteve të “huasë”. Diferenca rezultoi 55.0 milionë euro mjete të shtuara për sektorin në fjalë. Për sa i përket detyrimeve, raportohet një vlerë negative prej 40.0 milionë eurosh që nënkupton një pakësim të stokut përkatës. Në detaje, vihet re një pakësim i detyrimeve në formën e huasë për “korporatat depozitëmarrëse” dhe “sektorët e tjerë”. Ndërkohë, “qeveria e përgjithshme” ka shtuar detyrimet e saj me rreth 10.7 milionë euro. Paralelisht, është vënë re një rritje e detyrimeve në formën e “monedhave dhe depozitave”.

Bilanci i përgjithshëm i pagesave rezultoi me një shtesë të mjeteve të rezervës në masën 154.8 milionë euro. Në fund të muajit shtator 2018, stoku i rezervës valutore ishte rreth 3.1 miliardë euro. Ky nivel vlerësohet i mjaftueshëm për mbulimin e 6.5 muaj importe mallrash dhe shërbimesh ose 160% të borxhit të jashtëm afatshkurtër bruto.

Si pasojë e problemeve që mund të ndeshen në burimet e informacionit dhe gjatë hartimit të statistikave të sektorit të jashtëm, mund të ndodhë që bilanci i pagesave të ketë mospërputhje. Në statistikën e bilancit të pagesave, këto mospërputhje përmbledhen në zërin “gabime dhe harresa”, i cili llogaritet si “mbetje” (diferencë midis bilancit të llogarisë financiare dhe bilancit të

llogarisë korrente plus bilancin e llogarisë kapitale). Llogaria “gabime dhe harresa neto” rezultoi në një fluks hyrës prej 112.4 milionë eurosh dhe u vlerësua në 3.5% ndaj PBB-së nominale, për tremujorin e tretë 2018.



## V. PROFILI I FINANCIMIT TË DEFICITIT KORRENT


Në profilin e financimit të deficitit korrent është me rëndësi të monitorohet varësia ndaj flukseve hyrëse borxhkrijuese, kundrejt flukseve hyrëse joborxhkrijuese<sup>2</sup>. Kështu, flukset financiare joborxhkrijuese nga investimet direkte neto dhe nga llogaria kapitale u vlerësuan në nivelin 9.0% ndaj PBB-së nominale. Këto ishin rreth 3.8 pikë përqindje më të ulëta, krahasuar me një vit më parë. Flukset financiare borxhkrijuese u vlerësuan në nivelin -3.2%<sup>3</sup> ndaj PBB-së nominale, rreth 0.4 pikë përqindje më të ulëta, krahasuar me një vit më parë.

Pasi flukseve valutore neto borxhkrijuese dhe joborxhkrijuese në tërësi, u shtohen edhe gabimet dhe harresat neto, përftohet masa e financimit të përgjithshëm të deficitit korrent. Gjatë tremujorit në analizë, raporti i financimit të llogarisë korrente ishte në nivelin 205.8%, duke u përkthyer në një zgjerim të rezervës me 154.8 milion euro. Ky raport rezulton rreth 79.4 pikë përqindje më i lartë, krahasuar me një vit më parë, dhe 57.8 pikë përqindje më i lartë, krahasuar me tremujorin e mëparshëm.

<sup>2</sup> Kjo ndarje shërben për të monitoruar ndikimin që flukset financiare e kapitale kanë në borxhin e jashtëm të vendit. Flukset joborxhkrijuese përfshijnë Investimet Direkte dhe hyrjet neto të llogarisë kapitale, ndërsa flukset borxhkrijuese përfshijnë investimet e portofolit dhe investimet e tjera neto.

<sup>3</sup> Raporti negativ ndaj PBB-së nominale nënkupton një fluks neto mjetesh. Në këtë rasti, fluksi nuk financon deficitin korrent, por duhet të financohet përtej deficitit korrent.

Grafik 10. Flukset hyrëse financiare borxhkrijuese dhe joborxhkrijuese ndaj PBB-së nominale (majtas) dhe financimi në total i deficitit të llogarisë korrente (djathtas)



Burimi: Banka e Shqipërisë